



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.29/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Milena Gjeriq dhe Mr.sc.Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të dënuarit S. K., me vendbanim në P., rruga "...", nr..., të cilin e përfaqëson avokat Florian Petani nga P., përkitazi me kërkesën për lirim me kusht, duke vendosur sipas ankesës së të dënuarit, të paraqitur kundër vendimit të Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.347/2023, të datës 02.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 23.08.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të dënuarit S. K., me vendbanim në P., rruga "...", nr..., e paraqitur kundër vendimit të Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.347/2023, të datës 02.08.2023.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.347/2023, të datës 02.08.2023, në pikën I të dispozitivit refuzohet kërkesa për lirim me kusht e të dënuarit S. K., me vendbanim në P., rruga "...", nr..., nga i ati H. dhe e ëma Xh., e gjinisë K., i lindur më datë, në P., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Në pikën II ishte vendosur që kërkesa për lirim me kusht i refuzohet për periudhën kohore prej 3 (tre) muaj, e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Kundër vendimit të lartpërmendur, i dënuari, përmes të autorizuarit avokat Florian Petani nga Prishtina, me kohë ka paraqitur ankesë për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale që kanë të bëjnë me lirim me kusht; shkeljeve procedurale dhe gabimeve faktike siç thuhet në ankesë, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të ndryshoj aktvendimin e atakuar të Panelit për Lirim me Kusht ashtu që të aprovoj

kërkesën e të dënuarit dhe të liroj nga vuajtja e dënimit në atë mënyrë që do t'ia kushtëzoj pjesën e mbetur të dënimit ta kryej në shtëpi në pajtim me ligjin.

Paneli për Lirim me Kusht, në përgjigje në ankesën, e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e të dënuarit, me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa, ndërsa vendimi i kundërshtuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 11 dhe 12 të Ligjit nr. 08/L-132, për Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, shqyrtoi ankesën e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, vendimin e ankimuar, si dhe shkresat e lëndës, dhe gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e çështjes, dosja e të dënuarit, rezulton se i njëjti është shpallur fajtor për shkak të veprës penale nga neni 185 par. 2 dhe neni 366 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Nga raportet e përpiluara nga Ekipi Profesionist për të dënuarin, raporti ligjor për të dënuarin vërtetohet se i dënuari lirim normal e ka me datën 01.12.2023 dhe nga llogaritja e dënimit për të dënuarin rezulton se gjer më tani i ka vuajtur 9 muaj, 11 ditë, ndërsa i kanë mbetur edhe 5 muaj e 19 ditë. Nga raporti social për të dënuarin është konstatuar se sjelljet e të dënuarit janë relative për shkak të një shkelje disiplinore, mirëpo në përgjithësi është tip i qetë, komunikues, ka pranuar veprën penale duke u penduar. Sipas ekipit profesionist, gjatë vuajtjes së dënimit procesi i risocializimit ka rrjedhur në suaza të normales dhe mbetet të vlerësohet në ditët në vijim.

Paneli për lirim me kusht, gjatë shqyrtimit të kërkesës së të dënuarit, i ka vlerësuar kriteret të cilat janë të parapara me Rregulloren 01/39, mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për lirim me kusht e cila përcakton kriteret që duhet vlerësuar: 1.1 Pesha e krimit, 1.2 Historia e kaluar kriminale, 1.3 Përshkrimin e personit të dënuar për krimin, 1.4 Qëndrimin e personit të dënuar ndaj viktimës, 1.5 S Nga raportet e përpiluara nga Ekipi Profesionist për të dënuarin, raporti ligjor për të dënuarin vërtetohet se i dënuari lirim normal e ka me datën 27.07.2024 dhe nga llogaritja e dënimit për të dënuarin rezulton se gjer më tani i ka vuajtur 2 vite, 5 ditë, ndërsa i kanë mbetur edhe 11 muaj, 25 ditë. Nga raporti social për të dënuarin është konstatuar se i dënuari nga shqyrtimi paraprak i kërkesës, në përgjithësi ka treguar sjellje shumë të mira, angazhim dhe disiplinë në punë. Sa i përket qëndrimit ndaj veprës penale e pranon dhe ndjehet thellësisht i penduar. Sipas Ekipit profesionist të Qendrës Korrektuese, procesi i risocializimit të i dënuari ka rrjedhur në mënyrë progresive, duke arritur nivel të lartë në përmirësimin e tij. Nga të dhënat e raportit rezulton se i dënuari nuk ka shkelje të reja disiplinore që nga shqyrtimi paraprak i kërkesës së tij. planet e të dënuarit pas lirim, 1.10 Pranimi i

kontrollit dhe ndihmesës nga Shërbimi Sprovues, 1.11 Ekzistenca e një rreziku të përgjithshëm për publikun, dhe 12 perspektiva që një person i dënuar me orgjinë të huaj ka synimin që të kthehet në shtëpi.

Paneli ka vlerësuar, përveç kritereve edhe kushtet për lirim me kusht që i parasheh Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve penale dhe pas shqyrtimit të kërkesës, vlerësimit të gjitha kushteve dhe kritereve si më lartë, konstatoi se për shkak të peshës së veprës penale dhe vuajtjes së dënimit në raport me kohën e kaluar në vuajtje, shkeljes së mëparshme të rregullave të institucionit korrektues, ka ardhur në përfundim se ende nuk është arritur qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penal i paraparë sipas dispozitës së nenit 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 dhe 6 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, për shkak se pesha e krimit është një tregues i nevojës për të mbrojtur shoqërinë përmes parandalimit të kryerjes së veprave tilla apo të ngjashme penale, për të cilën arsye kërkesa e të dënuarit u refuzua për periudhën kohore prej tre (3) muaj, andaj e njëjta mund të shqyrtohet pas kalimit të këtij afati. Paneli për lirim me kusht në seancën e mbajtur me datën 02.08.2023, pasi e shqyrtoi kërkesën e të dënuarit, dosjen e tij, raportin përmbledhës të përpiluar nga Ekipi Profesionist i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Deklaratën-premtimin lidhur me mbikëqyrjen e të dënuarit pas lirimit me kusht, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nr.08/L-132, dhe pas vlerësimit të tërësishëm të çështjes gjeti se kërkesa për lirim me kusht është e pa bazuar.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e ankimuar, pasi që i njëjti është në tërësi i bazuar në ligj, dhe me këtë rast u pranuan si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të Panelit për Lirim me Kusht, të precizuara në tërësi si në këtë vendim. Refuzimi i kërkesës për lirim me kusht të ushtruar i dënuari, është i mbështetur në dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe në Rregulloren nr. 01/39, duke i shqyrtuar të gjitha rrethanat që parashihen me dispozitat ligjore nga ligjet e sipërcituar, dhe nga rregullorja nr. 01/39.

Gjykata Supreme e Kosovës gjeti kjo është ankesa e dytë e të burgosurit dhe se edhe një herë ishte vendosur sipas ankesës së të dënuarit të parashtruar kundër aktvendimit të Panelit për lirim me kusht PLK.D.nr.82/23 i datës 28.03.2023 ishte refuzuar ankesa. Gjykata Supreme vlerëson se ende nuk janë plotësuar të gjitha kushtet në mënyrë kumulative që i dënuari të lirohet me kusht, kjo për faktin se ende nuk është bërë risocializimi i tij në mënyrë të plotë ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore. Në raportin përmbledhës të ekipit profesionist t Shërbimit

Korrektues thuhet se përveç shkeljes disiplinore të datës 30.06.2021, në fazën e paraburgimit nuk ka shkelje tjera.

Në rastin konkret Paneli, duke vendosur për kërkesën e të dënuarit vlerësoi të gjitha kriteret e përcaktuara në dispozitën e nenit 14 të Rregullores nr.01/39, mbi Organizimin dhe Funksonimin e Panelit për Lirim me Kusht, dhe kushtet që parashihen në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe ka ardhur në përfundim se ende nuk është arritur qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penal i paraparë sipas dispozitës së nenit 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 dhe 6 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, andaj në rastin konkret Paneli me rastin e vendosjes mori parasysh edhe nenin 14 par. 1 pikën 1.1 të Rregullores nr. 01/39, ngase pesha e kimit është një tregues i nevojës për të mbrojtur shoqërinë përmes parandalimit të kryerjes së veprave tilla apo të ngjashme penale, për të cilën arsye kërkesa e të dënuarit u refuzua për periudhën kohore prej 3 (tre) muaj, andaj e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon qëndrimin e Panelit për lirim me kusht, se gjatë shqyrtimit të kërkesës së të dënuarit i ka marrë parasysh të gjitha kushtet dhe kriteret për lirim me kusht për të dënuarin që parashihen në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Rregullores mbi Organizimin dhe Funksonimin e Panelit për Lirim me Kusht. Nga raporti social për të dënuarin është konstatuar se i dënuari ka treguar sjellje relativisht të mira, ka një shkelje disiplinore. Procesi i risocializimit sipas Ekipit profesionist të Qendrës Korrektuese tek i dënuari ka progres në risocializimin e tij dhe do të vlerësohet sërish.

Pretendimet ankimore se përbërja e Panelit për Lirim me Kusht nuk është në përputhje me ligjin, sepse nuk është penalist, nuk qëndrojnë për faktin se zëvendësimi i Kryesuesit të panelit dhe zëvendësit të tij është bërë në përputhje me nenin 17 pika 5 Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ku përcaktohet se " Në rastet kur me ligj parashihet përjashtimi i anëtarit të panelit për lirim me kusht në një çështje të caktuar apo zëvendësimi, në mungesë të ndonjë anëtari tjetër, udhëheqësit e këtyre institucioneve delegojnë një person tjetër". Ky zëvendësim është i përcaktuar me ligj dhe është respektuar procedura e paraparë nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe i aprovuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës të cilët kanë vepruar në kuadër të kompetencave sipas ligjit. Fakti se njëri nga anëtarët e nuk është penalist është kushtëzuar nga përfshirja e gjyqtarëve tjerë penalist në rastin konkret dhe përjashtimi i tyre sipas fuqisë së ligjit.

Gjykata Supreme e Kosovës, pranon në tërësi konstatimin e Panelit për Lirim me Kusht, në vendimin e ankimuar, dhe se refuzimi i kërkesës nuk paragjykon mënyrën e vendosjes në rast të përsëritjes së kërkesës pas kalimit të afatit prej 3 muaj, ashtu siç është përcaktuar në vendimin e panelit. Me këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës vëren se është e limituar, në kufijtë e ekzaminimit të ankesave dhe shkaqeve për të cilat mund të atakohet vendimi i Panelit, siç parashihet me dispozitat e nenit 10 Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ku përcaktohet se "Ankesa mund të ushtrohet në rast të zbatimit të gabuar të dispozitave të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale që kanë të bëjnë me lirin me kusht; në rast të shkeljes procedurale të përcaktuar me ligj; në rast të një gabimi faktik të qartë apo të dukshëm i cili ndikon në të drejtat substanciale të palës në qoftë se ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës".

Përfundimisht Gjykata Supreme e Kosovës duke i respektuar kufijtë e ekzaminimit të ankesës dhe kompetencën e shqyrtimit, gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk gjeti se është zbatuar gabimisht ligji material, nuk janë shkelur rregullat e procedurës së paraparën për shqyrtimin e kërkesës dhe nuk ka ndo një gabim faktik lidhur me rastin konkret, prandaj edhe refuzoi si të pa bazuar ankesën e të dënuarit.

Për arsyet e paraqitura më lart, në bazë të nenit 117 paragrafi 11, 12, të Ligjit nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

AA.nr. 29/2023, më 23.08.2023

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami